

Seancës plenare
20.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2023

Lënda: Dërgohet kërkesa për pyetje Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Z. Ervin Mete

Drejtuar: **Znj. Lindita NIKOLLA**
KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

TIRANË

E nderuar Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,

Në bazë të nenit 95 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj që ti adresoj disa pyetje Ministrit të Financave dhe Ekonomisë:

Në tërmetin e datës 26 nëntor 2019, Kruja dhe zonat përreth saj pësuan dëmtime shumë të rënda, të cilat detyruan qindra familje të largohen nga shtëpitë e tyre dhe të trajtoheshin me bonus qiraje. Pavarësisht premtimeve të qeverisë, procesi i rindërtimit të banesave nga tërmeti është shumë i ngadaltë, edhe sot pas 4 vitesh, nuk ka ende zgjidhje për familjet e dëmtuara nga tërmeti. A ka ndonjë afat kur do të përfundojë ndërtimi i këtyre banesave? Për më tepër, familjet që trajtoheshin me bonus qiraje, prej muajit maj 2023 i është ndërprerë përfitimi i saj duke i lënë prej 5 muajsh pa asnjë zgjidhje.

Sa më sipër, kërkoj nga ana juaj një përgjigje se pse është ndërprerë përfitimi i bonusit të qirasë dhe çfarë zgjidhje ka menduar Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këto familje, të cilave prej 4 vitesh jo vetëm që nuk ju janë rindërtuar banesat por prej 5 muajsh nuk trajtohen as me bonus qiraje?

Me respekt,

Deputete
Merita Bakiu